



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.44/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.01.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Nika” shpk & “Mane/S” shpk & “Borshi” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-38101-10-03-2019 me objekt “*Rikonstruksion Rruge Unaza Lumalas - Melçan – Porodinë, Bashkia Korçë*” me fond limit 62,644,465.8 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 11.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: BOE “Nika” shpk & “Mane/S” shpk & “Borshi” shpk
Rruga Bulevardi Skenderbeg, pas kinema Millenium,
Shkodër

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frashëri” nr.10, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”,
i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të
Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e*

Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.10.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-38101-10-03-2019 me objekt “*Rikonstruksion rruge Unaza Lumalas - Melçan – Porodinë, Bashkia Korçë*” me fond limit 62,644,465.8 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 11.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 11.11.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 04.12.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Grand Konstruksion	35,882,080	I skualifikuar
- Nika	35,966,986	I skualifikuar
- Xhengo	36,661,600	I skualifikuar
- Almo Konstruksion	37,927,170	I kualifikuar
- Kupa	38,333,977	I kualifikuar
- Glavenica	38,790,713	I kualifikuar
- Vëllezrit Hysa	39,665,441	I kualifikuar
- Desaret Company	39,867,538.5	I kualifikuar
- Sireta 2F	40,000,000	I kualifikuar
- Blerimi	40,000,000	I kualifikuar
- Favina	40,040,375	I skualifikuar
- B93II	40,193,773	I skualifikuar
- Leon Konstruksion	41,180,735.40	I kualifikuar
- Company Riviera 2008	41,703,187	I kualifikuar
- BE-IS	43,765,691	I kualifikuar
- Infinit	43,774,340	I kualifikuar
- Ndërtimi	43,836,183	I skualifikuar
- RSM Company	44,068,763.51	I kualifikuar
- Alb-Building	45,111,825.6	I kualifikuar
- Kacdedja	45,854,753	I kualifikuar
- Pepa Group	48,518,115.47	I kualifikuar
- Rej	48,667,029.9	I kualifikuar
- Shansi Invest	49,472,152	I skualifikuar
- Hastoçi	50,321,936.6	I kualifikuar
- Pe-Vla-Ku	51,554,117.96	I kualifikuar

II.4. Në datën 04.12.2019 BOE “Nika” shpk & “Mane/S” shpk& “Borshi” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Bashkimi i operatoreve ekonomik Nika sh.p.k & Borshi sh.p.k, nuk ploteson kriterin 2.3.1 “Kapaciteti Teknik” përvojë të suksesshme në realizimin e kontratës”, pasi punimet e paraqitura nga operatori ekonomik Borshi sh.p.k si anetar i JV, nuk mund të konsiderohen si punime të ngjashme. Kontratat e paraqitura janë kontratat e “Sherbimit të pastrimit të qytetit Shkoder”,*
- *Gjithashtu Operatori Ekonomik “Borshi” shpk nuk përmbush kriterin 2.3.4 “Operatores ekonomike duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontrates.... ,nuk disponin licence për zbatim punimesh.*

II.5. Në datën 10.12.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Nika” shpk & “Mane/S” shpk& “Borshi” shpk kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre nga procedura e mësipërme e prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Vendimi është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo fakte që ekzistojnë. Nga ana jonë është plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko ligjorë.*

Së pari në lidhje me pretendimin se shoqëria Borshi nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme pasi kontrata e pastrimit me bashkinë Shkodër nuk përmbush kriterin e punimeve të ngjashme sqarojmë se bazuar në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit në mes të tre operatorëve ekonomikë operatori ekonomik ka marrë përsipër vetëm 3.61 % të punimeve totale dhe konkretisht punimet:

- *Tek kategoria III- veprat e artit vetëm zërin e punimit Transport dheu me auto deri 1.0 km tek nënkategoria C –Tombino Rrethore*
- *Tek kategoria I e punimeve Punime për trupin e rrugës aksi Lumalas-Melcan (0+000-1+560) do të kryejë zërin nr.1 Gërmim toke e zakonshme, seksion i lirë dhe zërin nr.9 Transport dheu me auto deri 1.0 km.*
- *Tek kategoria II e punimeve Punime për trupin e rrugës aksi Melcan Porodinë (1+560-3+600) do të kryejë zërin nr.1 Gërmim toke e zakonshme seksion i lirë dhe zërin nr.8 –Transport dheu me auto deri 1.0 km.*

Këto punime janë punime që i përgjigjen natyrës së aktivitetit që ushtron shoqëria Borshi shpk dhe janë identike me punimet që ka kryer kjo shoqëri tek kontratat e ngjashme që ka ngarkuar në sistemin e SPE. Në DT është përcaktuar shprehimisht nga ana juaj se: Punimet e ngjashme duhet të plotësohen nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesmarrjes së tyre në bashkim. Në këtë prizëm shoqëria Borshi ka paraqitur një kontratë të ngjashme në përputhje me punimet që ka marrë përsipër. Edhe ligjvënësi përcakton se punimet duhet të jenë të ngjashme dhe jo të njëjtat. E vetmja gjë është për të krijuar besueshmëri të AK se shoqëria është e aftë për të kryer punimet që ka marrë përsipër dhe do jetë eventualisht e suksesshme për realizimin e kontratës. Kështu që kjo pikë dhe ky kriter rezulton të jetë rregullisht i plotësuar sipas kërkesave tuaja.

- *Së dyti në lidhje me pretendimin se shoqëria Borshi nuk ka licencë profesionale ndërtimi sqarojmë se kjo shoqëri ka licencë profesionale nga QKL posacërisht për punimet që ka marrë përsipër të kryejë. Në DST nuk është përcaktuar se në rast bashkimi operatorësh ekonomikë secili operator duhet të ketë licencë profesionale ndërtimi . Sqarojmë se me këtë vendimarrje të kundraligjshme dhe jo të drejtë i shkaktohet një dëm relativisht i madh buxhetit të institucionit tuaj dhe taksave të shtetasve shqiptar.*

Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë Nika shpk.

II.6. Në datën 16.12.2019 me shkresën nr. 1808/1 prot bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Nika” shpk & “Mane/S” shpk& “Borshi” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 23.12.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.37 prot datë 08.01.2020 protokolluar me tonën me nr.1917/2 prot datë 08.01.2020 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues Nika” shpk & “Mane/S” shpk& “Borshi” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “*Gjithashtu Operatori Ekonomik “Borshi” shpk nuk permbush kriterin 2.3.4 “Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates.... ,nuk disponin licence per zbatim punimesh”*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Nika” sh.p.k & “Mane/S” sh.p.k& “Borshi” shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr. 13324 Rep, Nr.6189 Kol datë 11.11.2019. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “*Rikonstruksion Rruge Unaza Lumalas - Melçan – Porodinë, Bashkia Korçë*” Loti III.

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se “*Të tre shoqëritë do të kryejnë punimet së bashku në masën: 27.8% shoqëria Nika shpk, 68.59% shoqëria Mane/S shpk, 3.61% shoqëria Borshi shpk.*”

Shoqëria Nika shpk do të kryejë këto punime:

- Të gjitha zërat e punimeve tek kategoria IV Punime Sinjalistike,
- Të gjitha zërat e punimeve tek kategoria III-Veprat e Artit me përjashtim të zërit Transport dheu me auto deri 1.0 km tek nënkategoria C-Tombino Rrethore

- Tek kategoria I e punimeve Punime për trupin e rrugës aksi Lumalas-Melcan (0+000-1+560), do të kryejë zërin nr.2 Frezim shtrese asfalti me makineri, zërin nr.3 mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës përhapur e ngjeshur me makineri , zërin nr.5 shtresë stabilizanti t -10 cm dhe zërin nr.6 shtresë stabilizanti t-10 cm bankinat.
- Tek kategoria II e punimeve Punime për trupin e rrugës aksi Melcan Porodinë (1+560-3+600) do të kryejë zërin nr.2 mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës , përhapur e ngjeshur me makineri , zërin nr.4 shtresë stabilizant t-10 cm dhe zërin nr.5 shtresë stabilizanti t-10 cm bankinat.

Shoqëria Manes/S do të kryejë këto punime:

- Tek kategoria I e punimeve për trupin e rrugës Aksi Lumalas Melcan (0+000-1+560) do të kryejë zërin nr.4 shtresë cakulli 15 cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri, zërin nr.7 shtresë binderi me granil gur kave 5 cm me makineri dhe zërin nr.8 shtresë asfaltobetoni me granil guri kafe 4 cm me makineri.
- Tek kategoria II Punime për trupin e rrugës aksi Melcan Porodinë (1+560-3+600 do të kryejë zërin nr.3 shtresë cakulli 15 cm , makadam përhapur e ngjeshur me makineri, zërin nr.6 shtresë binderi me granil gur kave 5 cm me makineri dhe zërin nr.7 shtresë asfaltobetoni me granil guri kave 3 cm me makineri.

Shoqëria Borshi shpk do të kryejë këto punime:

- Tek kategoria III- veprat e artit vetëm zërin e punimit Transport dheu me auto deri 1.0 km tek nënkategoria C –Tombino Rrethore
- Tek kategoria I e punimeve Punime për trupin e rrugës aksi Lumalas-Melcan (0+000-1+560) do të kryejë zërin nr.1 Gërmim toke e zakonshme, seksion i lirë dhe zërin nr.9 Transport dheu me auto deri 1.0 km.
- Tek kategoria II e punimeve Punime për trupin e rrugës aksi Melcan Porodinë (1+560-3+600) do të kryejë zërin nr.1 Gërmim toke e zakonshme seksion i lirë dhe zërin nr.8 –Transport dheu me auto deri 1.0 km.

III.1.2. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

2.3.4 *Operatorët ekonomike duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP – 1 B Punime gjurmimi në tokë.
- NP – 4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP – 5 A Punime nentokesore, ura dhe vepra arti
- NP – 9 A Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
- NP – 11 A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, linja e TN e te mesem dhe shpërndarjen e energjise
- NP – 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS – 1 A Punime për prishjen e ndertimeve
- NS - 6 A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
- NS - 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore
- NS - 9 A Punime strukturore speciale
- NS - 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.**

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE ankimues në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Licencë NZ.2798/16 e operatorit ekonomik “Nika” shpk
- Licencë NZ.0440/22 e operatorit ekonomik “Mane/S” shpk

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë

organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.6. Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 2,3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet: Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje

III.1.7. Referuar parashtrimeve në ankesë BOE ankimues pretendon se ” në lidhje me pretendimin se shoqëria Borshi nuk ka licencë profesionale ndërtimi sqarojmë se kjo shoqëri ka licencë profesionale nga QKL posacërisht për punimet që ka marrë përsipër të kryejë. Në DST nuk është përcaktuar se në rast bashkimi operatorësh ekonomikë secili operator duhet të ketë licencë profesionale ndërtimi . Sqarojmë se me këtë vendimarrje të kundraligjshme dhe jo të drejtë i shkaktohet një dëm relativisht i madh buxhetit të institucionit tuaj dhe taksave të shtetasve shqiptar.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik referuar bazës ligjore të sipërcituar, gjykon se përmbushja e kriterëve të vecanta të kualifikimit duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe natyrën e punëve të marra përsipër për realizimin me sukses të kontratës. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit nga autoriteti kontraktor kërkohet që operatorët ekonomikë pjesmarrës të disponojnë kategoritë e licencave për punimet e zbatimit si vijon:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI: NP – 1 B *Punime gjërmimi në tokë.* NP – 4 C *Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale,* NP – 5 A *Punime nentokesore, ura dhe vepra artit,* NP – 9 A *Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime,* NP – 11 A, *Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjis,* NP – 12 A *Punime te Inxhinierise se Mjedisit.*

PUNIME SPECIALE NDERTIMI: NS – 1 A *Punime per prishjen e ndertimeve,* NS – 6 A *Sinjalistika rrugore jo ndriçuese,* NS – 7 A *Barrierra dhe mbrojtje rrugore,* NS – 9 A, *Punime strukture special,* NS – 18 A *Punime topogjeodezike.*

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se janë dorëzuar vetëm licencat e zbatimit të anëtarëve të bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë konkretisht “Nika” shpk dhe “Manes/S” shpk.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit rezulton se anëtari tjetër i këtij bashkimi “Borshi” sh.p.k ka marrë përsipër realizimin e zërave të preventivit për punime të tilla si:

Tek kategoria I e punimeve Punime për trupin e rrugës aksi Lumalas-Melcan (0+000-1+560) do të kryejë zërin nr.1 Gjërmim toke e zakonshme, seksion i lirë dhe zërin nr.9 Transport dheu me auto deri 1.0 km.

Tek kategoria II e punimeve Punime për trupin e rrugës aksi Melcan Porodinë (1+560-3+600) do të kryejë zërin nr.1 Gjërmim toke e zakonshme seksion i lirë dhe zërin nr.8 – Transport dheu me auto deri 1.0 km.

KPP gjykon se për kategorinë e punimeve të cilat ka marrë përsipër operatori “Borshi” shpk e konkretisht për zërat Gjërmim toke e zakonshme duhet të ishte i pajisur me Licencën përkatëse nga organet kompetente në përputhje me VKM nr.42 datë 16.01.2008 i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Licencë profesionale” është leja për ushtrimin e aktivitetit në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim me të cilin ka detyrimin të pajiset çdo subjekt juridik/fizik, privat ose publik, që dëshiron të ushtrojë veprimtari në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim dhe plotëson kushtet për t’u pajisur me një të tillë.*

N.P. 1 Punime gjërmimi në tokë Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

KPP gjykon se është pikërisht natyra e punimeve të marra përsipër nga shoqëria “Borshi shpk në marrëveshjen e bashkëpunimit e konkretisht zëri nr.1 gjërmim toke e zakonshme, e cila kërkon domosdoshmërisht që shoqëria të jetë e pajisur me kategorinë e licencës me kod

NP-1 për zbatimin e punimeve e cila referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]*”.

III.1.11. Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit. Në këtë kuptim pretendimi i bashkimit të operatoreve ekonomikë se *Në DST nuk është përcaktuar se në rast bashkimi operatorësh ekonomikë secili operator duhet të ketë licencë profesionale ndërtimi*, nuk është i bazuar pasi qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që secili nga operatorët e bashkimit të disponojë kapacitete e nevojshme teknike sikundër në rastin konkret licencën e zbatimit me kategorinë/kategoritë përkatëse të punimeve të lëshuar nga organet kompetente, për sa kohë që referuar natyrës së punimeve të marra përsipër edhe nga shoqëria “Borshi” shpk e bëjnë të nevojshme disponimin e saj.

Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k & “Mane/S” sh.p.k& “Borshi” shpk nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kriteri për paraqitjen e Licencës së zbatimit është plotësuar vetëm nga dy prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatoreve ekonomike ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe bashkimi i operatoreve ekonomike ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Nika” sh.p.k & “Mane/S” sh.p.k & “Borshi” shpk për procedurën e prokurimit, *“Procedurë e Hapur”*, me Nr.REF-38101-10-03-2019 me objekt *“Rikonstruksion Rruge Unaza Lumalas - Melçan – Porodinë, Bashkia Korçë”* me fond limit 62,644,465.8 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 11.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1917 Protokolli; Datë 23.12.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha